



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

Sesioni pranveror  
Komisioni për Integritet Evropian  
Mbledhja nr. 44  
Prishtinë, më 23.04.2019, në orën 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti dhe Donika Kadaj-Bujupi.

**Munguan:** Milaim Zeka dhe Adem Hoxha.

**I ftuar:** Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme.

**Zyrtar mbështetës të komisionit:** Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ, KDI, OJQ Aktiv dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare komisionit**

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportimi i z. Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme, lidhur me procesin e integritetit evropian;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetarja** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Raportimi i z. Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme, lidhur me procesin e integrimit evropian**

**Kryetarja** në fillim të raportimit ka shprehur mirëseardhjen për ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, z. Pacolli. Gjithashtu duke pas parasysh se ministri i Punëve të Jashtme është edhe kryesues i Këshillit të Stabilizim Asociimit, tha se është ftuar që të raportojë lidhur me zhvillimet e fundit që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian për Kosovën, për bashkëpunimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme me sektorët e tjerë lidhur me avancimin e agjendës evropiane në përgjithësi. Pastaj, cilat janë të arriturat dhe ngecjet në këtë drejtim.

Kurse për procesin e liberalizimit të vizave, Kosova ndodhet në një fazë, ku pret vendim- marrjen nga ana e shteteve anëtarë të BE-së, pasi tashmë është e konfirmuar që institucionet e Kosovës i kanë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me këtë proces. Nga raportimi është kërkuar të informohen se pas konfirmimit të këtyre të arriturave nga ana e institucioneve të BE-së, cilat veprime janë ndërmarr nga Ministria e Punëve të Jashtme me qëllim të lobimit të shtetet anëtare vendimmarrëse të BE-së me qëllim të prezantimit të arriturave të Kosovës në këtë proces.

Nga takimet të cilat janë realizuar nga deputetët me përfaqësues të shteteve të BE-së, u është thënë se ekziston një konfuzion sidomos te populli francez në mes të qytetarëve të Kosovës dhe Shqipërisë, sidomos kur raportohet në media për qytetarë të Shqipërisë të pjesë e madhe e qytetarëve francezë mendohet se po flitet edhe për Kosovën. Ka pyetur se cilat veprime janë marrë me qëllim të promovimit të Kosovës dhe të arriturave të Kosovës të shtetet anëtare të BE-së, të cilat hezitojnë për procesin e liberalizimit të vizave, e posaçërisht te ato të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Kurse sa i përket Procesit të Berlinit, ka pyetur se cilat janë obligimet dhe përfitimet të cilat i ka Kosova nga ky proces.

Ndërsa lidhur me pjesëmarrjen e deputetëve në nisma rajonale dëshiroj të dijë se a janë në dijeni se sa obstrukcione bëhen nga ana e Serbisë me qëllim të mos pjesëmarrjes së Kosovës në këto mekanizma, si dhe se sa janë prezantuar në takimet në të cilat diskutohet për bashkëpunimin rajonal?!

**Behgjet Pacolli** tha se është përgjigjur komisionit dhe ka dorëzuar një raport me shkrim i cili përmban informacione, përkitazi me kërkesën e Komisionit për Integritim Evropian. Sa i përket Marrëveshja e Stabilizim Asociimi (MSA) - Dialogu Politik, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) është e përkushtuar në zbatimin me sukses të MSA-së. Për shkak të mos njohjes nga pesë shtetet anëtare të BE-së, MSA-ja e Kosovës përmban nenin ku përmendet se asnjë pjesë e MSA-së nuk duhet të nënkuptohet si njohje e Kosovës nga institucionet dhe vendet anëtare e BE-së. Pengesat në rrugëtimin e Kosovës drejt integrimit evropian do të vazhdojnë të përcillen në këto rrethana, prandaj hapësira për të përfituar në rrafshin ndërkombëtar brenda kontekstit të kësaj Marrëveshje është e kufizuar. Segmenti i Politikës së Jashtme, Mbrojtjes dhe Sigurisë, pra Dialogut Politik me BE-në që kjo Ministri e mbulon, në rrethana normale do të nënkuptonte forcimin e lidhjeve të ndërsjella midis BE-së dhe Kosovës në gjashtë fushat si: harmonizimin e politikave të jashtme, sigurisë dhe të mbrojtjes; pjesëmarrjen në komunitetin ndërkombëtar demokratik; bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira ndërfqinjësore; normalizimin e qëndrueshëm dhe të dukshëm të marrëdhënieve me Serbinë; bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë; dhe harmonizimin e politikave për sanksionet ndërkombëtare dhe masat restriktive.

Ndër elementet kryesore të dialogut politik dhe afrimit me politikën e BE-së nënkuptohet përafrimi me deklaratat dhe qëndrimet e përbashkëta të Këshillit të BE-së në lidhje me situatat apo zhvillimet politike dhe në lidhje me situatat e të drejtave të njeriut dhe abuzimet në vendet e treta. Përderisa pala tjetër kontraktuese, Bashkimi Evropian nuk ka treguar interesim të duhur në zbatimin e kësaj pjese, mund të fitohet përshtypja që Kosova ka ngecur mbrapa në shfrytëzimin e dialogut politik me BE-në. Përkundër kësaj, deri më tani në vazhdimësi është dëshmuar se jemi duke e përafuar politikën tonë të jashtme me atë të BE-së, dhe këtë e kemi bërë përmes deklaratave publike duke e promovuar konvergencën me disa nga masat e përbashkëta të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë. MPJ ka hartuar një plan të veprimit me objektiva afatshkurta dhe afatmesme, me qëllim të zbatimit sa më të suksesshëm të tyre në kuadër të Dialogut Politik. Gjithashtu MPJ ka filluar të bashkëdyzojë qëndrimet e politikës së jashtme me ato të BE-së, dhe për këtë arsye janë marrë obligime për realizimin e masave legjislativë, si shembull për të qenë në gjendje të zbatojmë edhe sanksione të shenjestruara financiare. Meqenëse EEAS (Shërbimi i Veprimit të Jashtëm i BE-së) zyrtarisht, në këto rrethana, e ka të (pa) mundur ta ftojë Kosovën t'i koordinojë përafkrimin e politikës së jashtme, për shkak të mos njohjes nga BE-ja. MPJ ka përgatitur paraprakisht një analizë/dokument ku janë mbledhur të gjitha informatat e nevojshme të realizimit të përafritimit të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të vendeve të rajonit me BE-në.

Veprimet e ndërmarra nga MPJ-së për përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA. Aktivitetet e MPJ-së janë të përfshira në kuadër të kornizës së planifikimit të politikave të Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-se (PKZMSA). Disa nga masat që MPJ përmbush nuk reflektohen të kryera meqenëse shumica nga veprimet nuk mund të maten në mënyrë të prerë sepse zhvillohen në vazhdueshmëri, në kuptimin që edhe pse MPJ ka përfunduar obligimin, dokumentet janë në pritje të miratimit të qeverisë. MPJ ka marrë përsipër zbatimin e katër masave: njëra nga masat, respektivisht ajo e Planit të Veprimit për Zhvillimin sa më efikas të Dialogut Politik në mes të RKS dhe BE është konsideruar si e mbyllur vetëm për shkak të miratimit nga ana e Ministrisë edhe pse ky plan është në zbatim e sipër. Nga PKZMSA të vitit të kaluar raportohet që MPJ ka zbatuar 2 nga 4 e masave e paraparë. Kurse katër masat në përgjegjësi të MPJ-së janë: *Masat Legjislative*: Ligji për Sanksione Ndërkombëtare (draftimi i ligjit të ri për sanksione financiare të shenjestruara ndërkombëtare). *Masat Zbatuese*: Plani i Veprimit për Zhvillimin sa më efikas të Dialogut Politik në mes të RKS dhe BE; Strategjia për Punë të Jashtme; Numri i vizave të lëshuara shtetasve të vendeve të treta nga ana e Konsullatave dhe përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës. Nga këto katër masa, vetëm Masa e dytë e Planit të Veprimit për Zhvillimin sa më efikas të Dialogut Politik në mes të RKS dhe BE ka dalë si masë e përfunduar, ani pse kjo është miratuar nga ministri tani së bashku me institucionet e linjës realizon veprimet e parapara për vitin 2019. Përderisa Masa e tretë është Strategjia për Punë të Jashtme, e cila është finalizuar nga MPJ, por nuk është miratuar akoma nga qeveria. Masa e tretë është më shumë masë zbatuese e cila kërkon vetëm raportim dhe ka të bëjë me numrin e vizave të lëshuara shtetasve të vendeve të treta nga ana e Konsullatave dhe përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës, ky është proces që zhvillohet në vazhdimësi dhe kërkohet të kryhet në përpikëri. Sa i përket masës legjislativë, pra draftimin e projektligjit të ri, i cili për pjesën që e mbulon do ta zëvendësojë ligjin aktual të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare, qysh nga muaji qershor 2018 Grupi Punues është ngarkuar me draftimin e ligjit të ri që mbulon fushën e zbatimit të sanksioneve financiare të shenjestruara ndërkombëtare. Ky projektligj është bartur në Programin Legjislativ të Qeverisë 2019, dhe pritet të finalizohet ka mesi i vitit 2019. Gjatë vitit

2019, MPJ merre përgjegjësin e përfundimit të masave të pakryera gjatë vitit paraprak, si dhe raportimin për tri masat tjera në kuadër të Kapitullit 24 në bashkëpunim me MPB dhe institucionet tjera të linjës.

*Këshilli për Stabilizim Asociim (KSA):* Delegacioni i Kosovës në KSA përfaqësohet nga niveli i lartë politik i ministrave dhe përfaqësues tjerë të lartë të institucioneve dhe sipas rregullores 13/2016 ishte dashtë të kryesohet nga MPJ, dhe anëtarë të delegacionit duhet të jenë ministra dhe përfaqësues të tjerë të lartë të institucioneve, sipas agjendës. Mirëpo në tri takimet e para qysh nga viti 2016 është instaluar praktika që KSA-ja të kryesohet nga Kryeministri. Së fundmi Qeveria e Kosovës ka mbajtur takimin e tretë të Këshillit për Stabilizim Asociim së bashku me Komisionin Evropian më 17 Dhjetor 2018. Dhe si rezultat është theksuar përparimi në forcimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës për të zbatuar reformat e bazuara në *acquis* të kërkuara nga MSA, veçanërisht në 8 kapitujt e parë.

*Veprimet e ndërmarra nga MPJ, që ndërlidhen me procesin e Integritimeve Evropiane:* Ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme të Kosovës mbetet avancimi i partneritetit strategjik me Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Pjesë e madhe e agjendës së Brukselit përfshinë edhe marrëdhëniet e mira me vendet fqinje. Bashkëpunimi rajonal nuk është vetëm parakusht i integritimit, por një domosdoshmëri, orientimi i politikës së jashtme reflektohet edhe në pjesëmarrjen e Kosovës, pro aktive në nismat dhe organizatat multilaterale që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë. Kurse ndër të tjera janë paraqitur disa aktivitete të ministrit të MPJ-së: vizita zyrtare në Berlin me homologun gjerman z. Heiko Maas më 10 janar 2019; në kuadër të pjesëmarrjes në takimin joformal, organizuar nga Rumania, si kryesuese e Presidencës së radhës e Këshillit të BE-së, për vendet anëtare të BE-së, Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, ministri i MPJ ka marrë pjesë në takimin GYMNICH më 1 shkurt 2019; realizim i takimit bilateral me MPJ Rumun për herë të parë në Bukuresht; pjesëmarrja në Konferencën e Sigurisë në Mynih të Gjermanisë më 16 shkurt 2019; konsultimet politike me Italinë në Romë më 18. Shkurt 2019; vizita zyrtare e zv. ministres së Punëve të Jashtme znj. Rejhan Vuniqi në landin e Bavarisë me 14-15 Mars 2019; vizita zyrtare e zv. ministres Rejhan Vuniqi në Austri dhe përafrimi i protokollit për bashkëpunim kulturor me Austrinë; finalizimi i memorandumit për bashkëpunim mes Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe atij të Austrisë; pëlqimi për hapjen e Konsullatës së Nderit të Danimarkës në Prishtinë dhe akreditimi i zyrtarit nordik policor danez, jorezident në Prishtinë më 19 shkurt 2019; emërimi dhe akreditimi i Ambasadores së Kosovës në Suedi; agremani për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme në Malmö; Marrëveshja për bashkëfinancim të bursave në nivel të studimeve master e nënshkruar ndërmjet Francës dhe RKS-së e ratifikuar në Kuvendin e Kosovës më 30 janar 2019 e dekretuar nga Presidenti më 14 shkurt 2019; propozimi i marrëveshjes për punësimin e anëtarëve të familjes që është miratuar në parim nga Qeveria e Kosovës, e cila më 5 mars 2019 ka nxjerrë vendimin 05/92 nëpërmjet të cilit ngarkon MPJ-në për zhvillimin e negociatave me Qeverinë Franceze me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar; Shqyrtimi i propozim marrëveshjes për Themelimin dhe funksionimin e Agjencisë franceze për zhvillim (AFD – *Agence Française de Développement*), të Proparco dhe të Ekspertizës Franceze në Kosovë; Këshilli i Shteteve (Dhoma e Lartë e Asamblesë Federale të Zvicrës) ka mbështetur nënshkrimin e Konventës së re për sigurime shoqërore. Konventa mund t'i nënshtrohet një referendumi fakultativ, si dhe do të diskutohet edhe në Këshillin nacional para ratifikimit të saj. Kosova e ka ratifikuar Konventën në fjalë; Përgatitjet për konsultime politike më 20 maj 2019 në Berne; Hapja e Ambasadës në Portugali, dorëzimi i Letrave kredenciale nga Ambasadori jonë më 10 janar 2019 dhe tashmë

funksionalizimi këtij misioni diplomatik; Hapja e Zyrës ndërlidhëse ekonomike në Athinë; Marrëveshja për kredi të buta me Hungarinë; Vizita e MJ të Maltës në Kosovë; Përafrimi i marrëveshjes për tregti me Mbretërinë e Bashkuar; Përafrimi i ratifikimit të marrëveshjes për sigurimet sociale me Belgjikën; Përafrimi i marrëveshjes për patentë shofer me Italinë; Përafrimi i marrëveshjes për eliminim të taksave të dyfishta me Italinë; Përafrimi i marrëveshjes për eliminim e taksave të dyfishta me Gjermaninë; Nënshkrimi i kornizës për bashkëpunim 2019-2021 mes RKS dhe Maltës; Përafrimi i marrëveshjes për eliminim të taksave të dyfishta me Maltën; Ratifikimi i marrëveshjes për “Dhënien e granteve për vitin 2017” mes Kosovës dhe Gjermanisë më 02.01.2019 dhe Përafrimi i marrëveshjes për eliminim e taksave të dyfishta me Gjermaninë.

Sa i përket liberalizimi i vizave, BE-ja rreth Liberalizimit të Vizave nuk ka qenë korrekt ndaj Kosovës, autoriteteve dhe qytetareve. Edhe gjatë Presidencës Austriake të Këshillit të BE-së nuk ka pasur vullnet të përfshihet kjo pikë në rend të ditës, tashmë nga Presidenca rumune nuk duket të ketë lëvizje. Përgjegjësi e madhe mbetet te shtetet anëtare, dhe MPJ ka zhvilluar takime me shumicën e homologëve nga vendet anëtare të BE-së, të cilëve vazhdimisht ju kanë paraqitur të arriturat e Kosovës në këtë proces. Kryesisht hezitues janë ministrat e brendshëm dhe për këtë Këshilli i BE-së, ka qenë në një fazë të pritjes tejet të ngadalshme ndaj vendimit për liberalizimin e vizave për Kosovën, edhe për përfshirjen e kësaj pike në agjendë. Pa liberalizim po rrënohet kredibiliteti i të gjitha proceseve që kanë të bëjnë me BE-në. Institucionet e pavarura të Kosovës kanë bërë një punë të vazhdueshme dhe të shkëlqyeshme, dhe Bashkimi Evropian do ta rivlerësoj këtë arritje.

Procesit të Berlinit nuk është pjesë e Procesit të Stabilizim Asociimit, sidoqoftë e përmbush atë duke u fokusuar në rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe përafrimit të rajonit me BE-ne. Me 11 prill kam qenë i ftuar në Varshavë në takimin e Ministrave të Jashtëm të Ballkanit Perëndimor në kuadër të takimeve të Procesit të Berlinit, ku në margjina kemi organizuar takimin e parë të Fondit të Ballkanit Perëndimor, nën kryesimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, që nga janari 2019. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor janë zotuar së bashku që edhe ligjërisht të forcojnë bashkëpunimin e komponentëve të shoqërisë civile duke mbështetur projekte të përbashkëta dhe duke promovuar njerëzit në kontaktet me njerëzit. Kosova vazhdon të luajë rol konstruktiv në rajon edhe në kuadër të procesit të Berlinit. Në këtë kontekst, Republika e Kosovës vazhdon ta përcjellë me interes të pandryshuar këtë proces, ndërsa konkretisht MPJ është shumë aktive në përgatitjet që tashmë kanë filluar për samitin e radhës që kësaj radhe do të mbahet në Poznan, Poloni, më 4 dhe 5 korrik 2019. Ky proces ka evoluar ndërkohë dhe tash nuk kemi të bëjmë vetëm me aktivitetet që mbahen gjatë punimeve të samitit, por janë planifikuar një gamë aktivitetesh ku do të përfshihen edhe institucione dhe ministri të tjera, përfshirë ato që kanë të bëjnë me qeverisje lokale, ndërsa risi është organizimi i forumit të bizneseve dhe projektet përmes së cilave do të promovohet bashkëpunimi ndërkufitar. Procesi i Berlinit ka sjellë një moment të ri në Ballkanin Perëndimor si rajon. Kosova vlerëson përpjekjet shtesë të qeverive të shteteve anëtare të BE-së që investojnë në këtë proces me idenë që të mos zëvendësojë ose të kopjojë procesin e integritit në BE, por me idenë për të punuar komplementar në fushat specifike që kemi identifikuar gjatë këtij udhëtimi; Meqenëse një pjesë e MSA-së përfshin edhe bashkëpunimin rajonal, gjatë vitit aktual, vlen të theksohet që gjatë vitit 2019 Kosova është kryesuese e tre iniciativave rajonale: WBF (Janar), MARRI (Janar) dhe SEECF (Korrik); Përfaqësuesit e Kosovës po marrin pjesë aktive në iniciativat dhe organizatat e tjera rajonale dhe besoj fuqimisht se po kontribuojnë pozitivisht me punën së bashku me kolegët e tyre nga rajoni. Zbatimi i suksesshëm të MSA-së, suksesin e reformave të ndërmarra dhe

kontributin në bashkëpunim rajonal. RKS dhe rajoni në përgjithësi duhet të ecë përpara në procesin e integritimit evropian, dhe e rëndësishme është që BE-ja të reformoj procesin aktual të zgjerimit. Megjithëse Procesi i Stabilizim Asociimit ka sjellë shumë ndryshime pozitive në rajon, ai është një proces i ngadaltë. Zgjedhjet evropiane kanë mundësinë të forcojnë angazhimin në Ballkan dhe të demonstrojnë qartësi strategjike për të transformuar thellësisht rajonin tonë.

**Ismet Beqiri:** Tregoi se kanë pranuar raportin e MPJ-së dhe kërkoj që të paraqet disa konstatime dhe mendime të tij. Është bërë rregull që MPJ gjatë raportimit të paraqet ato që paraqet, por jo edhe vështirësitë e saj, duke nisur nga brenda siç është mos përkrahja e duhur sepse nganjëherë krijohet përshtypja që në Kosovë janë 5 politika të jashtme. Nisur nga të tre kërret vendit, pothuajse asnjëherë nuk janë me qëndrime të njëjta, por me qëndrime dhe mendime të ndryshme për çështje të njëjta. Pra, nuk flitet me një zë dhe si mund të pritët atëherë që për çështje të rëndësishme së veçantë, të tjerët të jenë më dashamirës sesa ne vetë, flasin ata që e udhëheqin Institucionet nuk dalin me qëndrime të njëjta, sepse është shumë normale dhe e drejtë që opozita mund të ketë edhe ka mendim tjetër për çështje të ndryshme, por qëndrimet e institucioneve dhe paraqitja e tyre dhe të qeverisë me mendime të ndryshme të cilat e dëmtojnë vendin dhe interesin e Kosovës. Si angazhim personal mendon se bënë një angazhim të mirë, por nuk bëhet punë e mirë nga këndvështrimi i angazhimeve që duhet të bëhen. Po ashtu është krijuar përshtypje se `ne nuk na duan` edhe pse janë përmbushur të gjitha standardet, dhe qytetarët e Kosovës nuk janë fajtorë për mos liberalizimin e vizave. Por situata në Kosovë nuk është krejtësisht e mirë. Korrupsioni, mungesa e sundimit të ligjit janë probleme evidente dhe në takimet e ndryshme u thonë këto. Këto janë problemet kryesore, siç po thuhet nga shteti i Holandës që ka një qëndrim të ftohtë, dhe sigurisht është për arsye se ne na shohin sa të nxehtë jemi për të bërë gjëra jo të mirazhe në kundërshtim me ligjin.

Sa i përket njohjeve, përkundër angazhimit të ministrit ka ngecur procesi i njohjeve për Kosovën dhe pyeti se sa vërtet është numri i njohjeve aktualisht. Sepse ka pasaktësi dhe nuk dihet sa njohje ka Kosova dhe sa njohje janë tërhequr. Diplomacia është një fushë shumë e gjerë dhe kërkon një armatë të tërë njerëzish, por nga ajo që është parë në vizitat e ndryshme zyrtare, një numër i madh ambasadorësh e bëjnë punën shumë mirë, ndërsa një numër tjetër janë vetëm numër dhe kontribut i saj janë qeverisjet paraprake. Gjithashtu ka pyetur për rolin e Konsullatës së Shqipërisë në OKB dhe raportet e saj, shprehu shqetësimet me sjelljet që i kanë dhe këtë e kishte provuar vet një vit më parë. Kosova duhet të koordinojë me Shqipërinë aktivitetet e tyre të jashtme. Në misionet diplomatike ka po ashtu njerëz jo adekuat të cilët nuk e bëjnë punën ashtu si duhet dhe shpesh herë janë me mandate të zgjata.

Kurse pyetjet që shtroj ishin:

E para, çfarë ju thonë juve për taksën, që Serbia jo vetëm e ka merituar taksën po meriton edhe shumë ma shumë, dhe a po mbetet ende problem apo jemi kah i bëjmë vetit qejf që bën edhe me taksën, por bën edhe pa taksën për të ecur përpara. Unë i takoj një subjekti politik LDK-së, që gjithmonë ka qenë dhe është për t'i zgjedhur problemet me dialog. Nuk e sheh jetike njohjen nga Serbia sepse Kosova mund të jetoj edhe pa njohjen e saj, fatkeqësi është mos njohja nga pesë vendet anëtare të BE-së. Ky vit vendimtar sa i përket liberalizimit të vizave, ndërsa qytetarët e Kosovës po dalin jashtë fatkeqësisht me ose pa viza, ata janë duke u pajisur për të lëshuar vendin sepse nuk kanë siguri dhe perspektivë. Pyetja tjetër: a po ju thonë juve në Mal të Zi që është kryer puna e kufirit apo jo? Nëse ju thonë që është kryer, dikujt i vjen keq sepse llogaritet që janë humb shumë hektar, ndërsa dikujt i vjen mirë sepse llogaritet që s'është humb

asnjë hektar, ajo që duhet me ditë është nëse konsiderojmë si të mbyllur, apo varët nga opinioni dhe qëndrimet!

**Ismaj Kurteshi** tha se e ka lexuar raportin e MPJ-së dhe konstatoi që ka shumë lëshime gjuhësore dhe në formulim të fjalive, andaj ka kërkuar që stafi në ministri që raportet t'i përpunojnë më mirë para se të dërgohen. Theksoj disa konstatime të raportit, të cilat janë problematike. Tha: Ju keni thënë, përveç tjerash në raport, se Kosova ka ngecje mbrapa në shfrytëzimin e dialogut me BE-në, domethënë është pranuar se këtu ka ngecje dhe kjo është një problem i madh meqë ne jemi të orientuar kah Evropa. Në një konstatim tjetër thuhet se, kemi dëshmuar se jemi duke përafruar politikat tona me BE-nëpërmes deklaratave tona publike. A mjafton që vetëm përmes deklaratave publike ne të përafrohemi me BE-në apo BE-ja kërkon që ato deklarata, ne t'i bëjmë realitet edhe me punë për të cilat deklarohemi se do t'i bëjmë. Me deklarata duket se jemi mirë, pastaj po dalin shumë probleme me integritet në Evropë. Si ministri, keni harruar edhe miratuar në fund të vitit të kaluar planin e veprimit për 6 fusha, dhe kanë kaluar 4 muaj nga ajo kohë duke i përmendur disa gjëra nga vizitat tuaja, kurse nuk treguat se për këto 4 muaj cilat janë të arriturat për realizimin e këtij plan veprimi. Ndërsa nga katër masat keni përmbushur vetëm një masë dhe tre tjera kanë mbetur të pa përfunduara. Po ashtu si ministër paraqit angazhimet pa përmendur dështimet që kanë ndodhur gjatë mandatit të Qeverisë Haradinaj, ku ju jeni ministër i Punëve të Jashtme. Folët për viza kurse vizat janë dështim sepse kanë qenë premtim edhe para dy viteve, para një viti dhe sikurse u premtua sot, mirëpo nuk janë realizuar dhe kjo është dështim. Pastaj dështim sepse nuk jemi pjesë e Interpolit, tërheqja e njohjeve dhe mungesa e njohjeve të reja.

Ndërsa parashtrij pyetjet: Në seancat e Kuvendit në pikën pyetjet parlamentare jeni njëri nga ministrat që më së shumti mungoni në këtë pikë edhe pse e keni përgjegjësi që të vini dhe të përgjigjeni në këto pyetje, pse po ndodh që ju po mungoni? Pyetja në vazhdim ishte, kur do të rishikohet marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi, bazuar në marrëveshjen e dy Presidentëve? Ajo pritet të fillon sepse kështu është deklaruar Kryeministri aktual. Nga të gjithë është thënë se një marrëveshje mes dy Presidentëve ka me vendos kufirin në Çakorr dhe te Kulla, kjo çështje duhet të ndodhë gjatë kësaj qeverisje. Sa njohje të reja kanë ndodhur gjatë qeverisjes Haradinaj, gjatë kësaj kohe që ju jeni ministër i Punëve të Jashtme? Pastaj, si po reflekton në Evropë, jashtë vendit, dallimet në qëndrimet e Presidentit dhe të Kryeministrit, siç është korrigjimi i kufirit, taksa dhe çështjet tjera. Dhe e fundit, u potencuat hapja e Ambasadës në Portugali, hapjen edhe katër misionëve diplomatike sipas raportit. A keni bërë përpjekje që hapjen e konsulatave dhe ambasadave ta koordinoni me Republikën e Shqipërisë që të bëhet bashkë dhe të jepet një shembull ndryshe nga ajo që e tha Ismeti.

**Zenun Pajaziti** tha se është mirë që jeni, sepse opozita kishte krijuar përshtypjen që nuk keni për të ardhur në komision. Kurse pyetjet shpesh herë tejkalojnë këtë komision, por është mirë të shtrohen pasi që jeni rrallë në këtë komision. Me vetë faktin që në raport është përmendur roli i MPJ-së në procesin e integritetit evropian, ka nevojë të ketë një bashkëpunim, koordinim dhe angazhim më i mirë, sensibilizimin dhe përgjegjësinë. Ne, duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të mobilizohemi të gjithë për të përmirësuar dialogun me BE-në në rrugëtimin jetik të Kosovës. Duhet të analizohen të gjitha energjitë dhe kapacitetet që ekzistojnë që ky dialog të jetë në nivelin e duhur, sidomos me Brukselin, vëmendje më të madhe të Kryeministrit. MPJ-ja ka kapacitete

dhe diplomat të mirë. Kurse dihet që në plot vende ka pasur dështime në proceset e reformave si shtetet të reja në rajonin tonë.

Çështja e bashkëpunimit rajonal është një çështje tjetër që është përmendur edhe në raportin e ministrisë, që sivjet Kosova është nikoqire e tre nismave regjionale. Madje disa prej deputetëve të Kuvendit janë edhe pjesëmarrës të këtyre nismave për bashkëpunim regjional të Evropës juglindore si “SECP”. Do të mbahet në korrik të këtij viti në Prishtinë dhe ka një lobim që aktivitetet të jenë me disa kufizime. Kërkohej që të jeni konciz, sepse Kosova është anëtare e barabartë prej samitit të Tiranës edhe do të ishte mirë që gjithçka të shkojë siç është shkuar në vende tjera. Beson se Kosova është e gatshme me kryesuar nismë Rajonale dhe të dalë faqebardhë. Kjo është një sfidë e rëndë por është e mirë për me dëshmuar kapacitetet para tjerëve, dhe ndoshta është mundësia për të bërë edhe ma mirë se sa vendet tjera. Për pjesëmarrje në nisma rajonale duhet një koordinim më i mirë, shembull në Bosnje nuk kanë përfaqësi diplomatike as Kosova siç dihen arsyet dhe as Shqipëria, kurse në Kroaci kanë që të dyja. Kurse ne kemi marrëveshje bashkëpunimi me Shqipërinë për koordinimin e këtyre aktivitetëve. Shqipëria është mirë ta dërgojë me marrëveshje me Kosovën një përfaqësi diplomatike në Bonje dhe Kosova në Kroaci.

Pyetjet janë drejtuar rreth përgatitjeve për nisma rajonale, cilat janë parashikimet për të qenë gjithçka e përgatitur.

**Behgjet Pacolli** tha se Kosova ka gjithsej 116 njohje, prej këtyre me mbi 90shtete ka marrëdhënie diplomatike, dhe se është vendi lider në rajon me numrin e njohjeve dhe marrëdhënieve diplomatike. Edhe më tutje Kosovës i duhen njohje, janë pranuar mbi 110 nota verbale për njohje, 6 nota verbale nuk kanë ardhur për arsye të rregullimit të brendshëm siç janë vendet e “Commonwealth-it”. Notë verbale nuk ka nevojë as kur krijohen marrëdhënie diplomatike. Për shembull Kenia është një shtet nën influencën ruso-serbe, mirëpo ajo ka mbështetur Kosovën në INTERPOL, UNESCO dhe do të mbështet në nismat tjera ndërkombëtare. Ky shtet nuk është në listën e vendeve që e njohin Kosovën, por as nuk ka marrëdhënie diplomatike, por kjo nuk do të thotë se qytetaret tonë nuk mund të udhëtojnë në këtë vend. Apo edhe në vendet tjera siç është Etiopia. Gjithashtu ka vende tjera që mbështesin Kosovën dhe që nuk ka notë verbale, por pritet ndërrimi i ambasadorëve, por ka shtete që kanë njoftuar me notë verbale, por ende nuk kemi marrëdhënie diplomatike, siç është rasti në Tanzani.

Kurse sa i përket tërheqjeve të njohjeve, është e vërtetë që kanë shkuar disa njerëz në Beograd, disa përfaqësues të ministrive të ndryshme të Punëve të Jashtme të shteteve të ndryshme sidomos shtete të vogla shumë të vogla nga Oqeania dhe Afrika, shtete të varfra ekonomikisht të dobëta, dhe është lexuar një dokument, i cili është vetëm një mashtrim i cili i është bërë këtyre shteteve. Një dokument ku shkruhet se Kosova e ka në funksion ende `Rezolutën 1244` të Kombeve të Bashkuara. Praktikisht kësaj rezolutë ende nuk është qartësuar situata e jonë sepse në të gjitha marrëdhëniet tona me Kombet e Bashkuara veprojmë sipas rezolutës “1244” sa i përket kontakteve tona. Prezenca e UNMIK-ut vepron në kuadër të kësaj rezolutive. Po ashtu është munduar të marrë një vërtetim nga Brukseli se dialogu Kosovë – Serbi nuk është për statusin e Kosovës, por për normalizimin e marrëdhënieve. Kjo është ndër arsyet që shtojnë këto vende që të presin se çfarë do të ndodhë me kalimin e kohës. Ndërsa Serbia u bënë presione duke thënë se janë duke interferuar drejtpërdrejt, pasi që ende nuk kanë një marrëveshje me Kosovën. Nuk ka asnjë letër që është pranuar përveç Ujdhesave Solomon ku thotë se deri te përfundimi i dialogut me Serbinë, ata i ngrijnë marrëdhëniet me Kosovën deri në përfundimin e dialogut. Mirëpo nuk ka tërheqje. Gjithashtu janë lëshuar shumë deklarata të pa kontrolluara nga Kosova, se ende nuk e dinë statusin e vet. Janë



zhvilluar takime të ndryshme dhe ju është bërë e ditur se Kosova e ka të rregulluar statusin e vet nga 2008 dhe po ashtu vendimin e gjykatës ndërkombëtare “GJND”-së, ku ju është dërguar secilit shtet.

Përveç letrës nga Ishujt Salomon, MPJ nuk ka marrë asnjë letër nga këto vende të cilat Serbia pretendon se kanë tërheq njohjet. Kurse vetëm dy njohje kanë ndodhur gjatë këtij mandati qeverisës. Pastaj tregoj rastin Kenia dhe takimet me zëvendëspresidentin e Kenisë. Në drejtimin e vendeve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, kjo e fundit nuk ka asgjë çfarë të ofrojë me qëllim të arritjes së njohjeve, sepse ato vende kryesisht janë vende që thithin investime dhe Kosova nuk ka potencial për investime. Ndërsa një rast i tillë është Nigeria që është përfol se z. Pacolli dhe ka marrë përmasa ligjore, ka shkuar deri në “EULEX”, për t’u vërtetuar se ka qenë veprimi i drejtë ku në një kredi të Francës është kërkuar që bashkë-kontraktore të jetë Kosova për atë pjesën që mundet me ofruar Kosova që është fuqia punëtore. Ndërsa është keqkuptuar që ka të bëjë me biznes personal, kurse sot është arsye pse janë marrëdhëniet e mira me Nigerin.

Gjatë këtij mandati janë iniciuar marrëdhëniet diplomatike me Tajlandën, dhe është gati hapja e Ambasadës atje. Ndërsa me Bangladeshin janë duke u bërë përpjekjet për emërimin e përfaqësuesit diplomatik. Është kërkuar hapja e ambasadës në Tanzani dhe pritet vendimi i qeverisë së këtij shteti. Ndërsa në Portugali është hapur ambasada e Kosovës, kurse në Katar është në proces të hapjes, ndërsa nga Kuvajti pritet miratimi. Është fuqizuar më tepër ambasada në Senegal. Kosova ka pranuar ambasadorë jo rezident nga shtetet e Amerikës së Jugut, dhe është kërkuar që edhe Japonia të hapë ambasadën e saj këtu në Kosovë. Si ministër tha se ka vizituar 54 shtete Afrikës dhe së paku tre herë.

Kurse sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave, tha se ka qenë optimist për arsye se është premtuar se do të heqin vizat për qytetarët e Kosovës, dhe si ministër i MPJ-së ka vizituar shumë vende duke filluar prej Maltës, e Italisë, Francës dhe Gjermanisë, Austrisë, Holandës, Hungarisë, të gjitha shtetet të cilat është dashtë dhe që kanë ndikimin e tyre, shtetet të cilat e influencojnë njëra –tjetrën, siç është Gjermani dhe Franca. Në veçanti marrëdhënie të mira diplomatike janë realizuar me ministrin gjerman Mas, dhe në takimet në Varshavë ka takuar edhe atje ministrin gjerman Mas me të cilin janë zhvilluar biseda rreth çështjes së vizave. Kështu që beson se këtë vit do të ndodhë liberalizimi i vizave.

Sa i përket integriteteve, Kosova tani për tani është e përfaqësuar, do të thotë udhëheq me tre nisma rajonale. Me “RYCO”-n, tentativa e “RYCO”-s që të bëhet takimi këtu, takimi do të mbahet në një vend neutral. Në Varshavë është takuar dhe me zëvendësen e Mogerinit dhe ka folur gjatë për këtë temë. Bashkimi Evropian i respekton strikt nismat rajonale dhe përfaqësimi i Kosovës përmes ministrit të jashtëm bëhet me emër dhe jo me simbole të shteteve. Ndërsa Fondi për Ballkanin Perëndimor nuk është mbajtur këtu për shkak të mungesës së kuorumit për shkak të mos pjesëmarrjes së Serbisë dhe Bonje e Hercegovinës, për këtë arsye është realizuar në Poloni në margjinat e samitit të Varshavës. Në këtë takim janë marrë disa vendime, janë aprovuar disa projekte, ishin projekte rajonale dhe aty u vendos që ky Fond i palëve të rritet nga 60 në 90 mijë Euro në vit. Kështu që, sa i përket “CEECP”-së edhe kjo është një organizatë jashtëzakonisht me rëndësi dhe Kosova do të marrë kryesimin nga 1 Korrikut i këtij viti.

Sa i përket ardhjes së disa qytetarëve të Kosovës (grupit siç njihet) nga vendet e konflikteve, dihet se një dosje sekrete dhe nuk është dashur që të flitet publikisht, edhe pse ka qenë një sukses i Institucioneve të Kosovës që qytetarët e vet t’i kthej në vendlindje me mbështetjen e miqve tradicional. Ndërsa për fajtoret dhe përgjegjësinë do të merret gjykata dhe ligji.

Ndërsa për dialogun politik, është e paraqitur në raportin e dërguar komisionit. Situata është e tillë se nga BE-ja nuk njohje të plotë të Kosovës. Nuk konsiderohet e drejtë që veprimet të harmonizohen me BE-në, edhe pse BE ka kërkuar disa herë nga institucionet e Kosovës opinione të ndryshme dhe veprime sikurse rasti i konferencës të ruajtjes së ambientit në Bon, siç është kërkesë e përgjithshme për harmonizimin.

Kurse sa i përket diplomacisë së Kosovës, në të kaluarën ka pasur një disbalancë ndërmjet kadrove profesionale ose të karrierës dhe atyre politike. Ndërsa sot ekziston një balancë 50 – 50 % e tyre. Kosova ka ambasador të jashtëzakonshëm të mirë, të tjerë që janë konvertuar nga politika në ambasadorë të karrierës, po ashtu pajtohet që ekziston ende një staf i cili duhet të rregullohet. Ministria është duke i thyer disa dhe duke dërguar njerëz të rinj nëpër misione diplomatike.

Sa i përket mos prezencës së tij në seancat e parlamentit është arsyetuar me udhëtime e shpeshja jashtë vendit dhe pamundësinë që të jetë i pranishëm në raportimet e ndryshme. Nga 30 marsi i viti 2018 deri me 31 dhjetor ka qenë jashtë vendit (mbi 90 ditë). Ndërsa shpesh herë lajmet e ndryshme nëpër media i ka cilësuar si të pa sigjerta, në veçanti kur thuhet jepja dorën presidentit Trump në korridoret e OKB-së. Kosova do të bëjë diplomaci çfarë do që të jetë e nevojshme. Po ashtu personalisht njeh presidentin amerikan, dhe nuk është ndjerë mirë kur ka dëgjuar nga mediat dhe shoqëria civile rreth kësaj pas një aktiviteti prej katër ditësh të realizimit të 74 takimeve të ndryshme bilaterale. Sidomos pas ardhjes së zëvendës presidentit të Kenia në Kosovë duke e cilësuar si një kriminel. Kjo është shfrytëzuar nga Beogradi në dëm të Kosovës.

Për çështjen e demarkacionit me Malin e Zi tha se institucioni që përfaqëson është ithtar i fqinjësisë së mirë dhe në fillim të mandatit të tij ka shkuar atje me qëllim të hapjes së rrugës për dialog dhe marrëveshje. Ajo marrëveshje është nënshkruar dhe është ratifikuar si dhe i ka kontribuar zgjidhjes së çështjes. Kryeministri i Kosovës e ka shkarkuar komisionin e mëparshëm që është marrë me demarkacion, dhe ka formuar një komision tjetër, ndërsa ky komision në qeveri ka sjellë dëshmitë e tij, ashtu siç është parë në media. Ekziston një marrëveshje në mes të dy presidentëve, atij të Kosovës dhe Malit të Zi që i jepet mundësi një korigjimi të demarkacionit që ka ndodhur, mirëpo ende nuk ka ndodhur delimitimi ose shënimi i kufirit. Mali i Zi ka aprovuar një dokument që i hapë rrugë delimitimit të kufirit, do të thotë komisionit i hap rrugë që të takohem me komisionin përkatës në Kosovë dhe të bëjnë delimitimin e kufirit. Ndërsa nuk e dinë a do të jetë ai delimitim i cili do ta kënaqi palën Kosovare, opozitën ose koalicionin apo personat e ndryshëm të involvuar. Dhe nuk ka informacione se kur do të zhvillohen takimet.

Në lidhje me qëndrimet e udhëheqësve në Kosovës sa i përket dialogut, tha se është munduar që t'i përmbahet eprorëve të tij dhe të harmonizoj ose unifikoj qëndrimet jashtë. Madje është munduar që të jetë unifikues qëndrimesh dhe brenda vendit, si të qëndrimit të kryeministrit, presidentit, të opozitës dhe të grupit negociues. Me rëndësi është se Kosova është e hapur për dialog, i nevojitet dialogu dhe ajo nuk diskuton për kufijtë, por është e gatshme që të kontribuojnë drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve me shtetin fqinj, me Serbinë. Tashmë Kosova ka një ekip për dialogun i cili del nga parlamenti i Kosovës. Kurse taksa ka arritur maksimumin e saj dhe kohet e fundit është duke u banalizuar. Sjelljet e kryeministrit serb janë të ndryshme, herë viktimizohet dhe gjuhëzohet duke kërkuar heqjen e taksës, kurse ditën tjetër fyen dhe krijon narracion të pa vërtetë, dhe taksa i bënë mirë atij. Mirëpo këtu kemi një interes krejtësisht tjetër e shoh se taksa kohët e fundit është duke dëmtuar Kosovën sa i përket relacionit edhe me miqtë tanë, kështu që shpreson që do të ketë një konsensus, gjithë qeveritar po edhe kombëtar në Kosovë, që sa më shpejt të dilet nga kjo takse dhe të hapim perspektivë për dialog dhe mos të marrët faji. Kryeministri ka qëndrime pro

dialogut dhe do të shihet çka do të ndodhë në takimin e Berlinit, i cili pritet që të marrë pjesë po ashtu në Berlin. As Kryeministri dhe as Presidenti nuk e dinë saktësisht çka do të ndodh në këtë samit, por është një tendencë e lidhshme evropiane që ta marrë situatën në dorë, duke dëshmuar dhe thënë se Kosova dhe Serbia i përket Evropës, dhe ne nuk mund të jemi duarkryq, për arsye se çdo pa siguri që ndodh ajo do të reflektohet edhe në Evropë.

**Armend Zemaj** tha se shumë çka u elaboruar faktikisht për shkak të interesimit të deputetëve. MPJ përfshinë një gamë të gjerë, por është e ndërlidhur me dikasteret e tjerë të qeverisë, dhe me punën që ndërlidhet me integrimet evropiane. Shihet një mungesë e koordinimit të duhur ndërmjet institucioneve për mbështetje në procesin e integritimit evropian dhe të politikës së jashtme. Dy çështje kryesore, e para mos zbatimi i MSA-së, mos plotësimi i masave së janë të obligueshme për zbatim (nga 4 masa MPJ ka realizuar vetëm 1). Kurse e dyta është procesi i liberalizimit të vizave, në raportin e ministrisë më shumë shihet gjuhë kritike për BE-në se sa përgjegjësi për përmbushje të obligimeve. Krimi dhe korrupsioni, pastaj zyrtarë të lartë me akuza (ministra, zëvendësministra), rrëmbimi i qytetarëve të huaj, si dhe keqpërdorime të tjera janë pengesë e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën. Madje ky vit nuk është optimist sepse gjashtë mujorin e parë të presidencës së BE-së e mban Rumania. Po ashtu theksoj se, Afrika është bërë kompleks për ministrin e MPJ-së duke koncentruar një pjesë të madhe të kohës, ndërsa fokusi më i madh i kësaj ministrie duhet të jetë Evropa dhe kryesisht lobimi të pesë vendet të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Sepse krejt marrëveshjet të cilat janë në dobi për Kosovën janë me vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e rajonit. Pra, shprehimisht kërkoj fokusin më të madh të MPJ-së në angazhimet në vendet e Evropës dhe pesë shtete anëtare të BE-së të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, si dhe të vendet të cilat e kanë njohur Kosovën, mirëpo nuk kanë dhënë votën pro në organizatat ndërkombëtare siç është INTERPOL, etj. Një angazhim në këtë drejtim duhet të bëhet nga të gjithë duke përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës.

Në kuadër të angazhimeve të institucioneve tona duhet të ketë një koordinim ndërmjet tyre dhe kryesisht me Ministrin e Integritimit Evropian sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave, kryesisht të ato vende të cilat janë skeptike në këtë drejtim.

**Fatmire Kollçaku** u shpreh se është hera e parë e ministrit që i përgjigjet këtij komisioni pas shumë përpjekjeve. Në raportin u paraqitën shumë përpjekje janë duke u bërë dhe disa punë që janë në mes, por në aspektin e integritimit evropian, nëse vlerësohet punën e Ministrisë për Integritim Evropian edhe punën e Ministrisë për politikë të jashtme, me keqardhje duke u bazuar në realitetin, domethënë mos anëtarësimi në "INTERPOL", në "UNESCO", pengesat që bëhen nga Serbia, etj. Si ministër ju keni pranuar me ju nënshtrua presioneve politike edhe për shkak të koalicionit qeverisës për kuptimin e asaj se politika e jashtme nuk është një lojtar i vetmuar, nuk është ajo çfarë bëni vetëm ju personalisht, udhëtimet e juaja. Disa ambasadorë, në shumë vende tjera, mund të sjellin dëme ose thjesht mos të bëjnë asgjë edhe pse është i emëruar politik, me ndikime të mëdha politike dhe ka shprehje të pakënaqësive prej njohësve të kësaj fushe, dhe jo vetëm nga opozita. Vërejtje të mëdha për punësime partiake nëpër misione diplomatike.

Ndërsa ka pyetur nëse ka ndonjë raport të mirëfilltë në ministrinë që ai drejton për punën dhe mos punën e zyrtarëve të cilët janë të emëruar në misionet diplomatike jashtë vendit. Pra, pavarësisht angazhimeve shihet një bilanc negativ dhe duhet parë nëse ministri ose stafi i ministrisë është gabim, ku përfillet për punësime dhe mbi

punësime partiake politike. Ndërsa pyetja e dytë kishte të bënte me politiken e jashtme pas ndryshimeve në MPJ-në e Shqipërisë, në veçanti me emërimin e ministrit të Punëve të Jashtme në detyrë, a ka diçka në përfrimin e raporteve me Shqipërinë duke i parë pas takimeve të fundit që ndodhën në Pejë. Ndërsa është e kuptueshme nëse kemi një koordinim të përbashkët në kuadër të lobimit nga të dy politikat e jashtme të vendeve tona. Ndërsa nuk është i pranueshëm mos bashkëpunimi dhe të pësojnë qytetarët e Kosovës, edhe sepse janë të një kombi dhe ka interes. Pra, këto dy çështje u parashtruan, pra raporti me Shqipërinë dhe raporti i MPJ-së lidhur me stafin e saj brenda dhe jashtë vendit, si dhe natyrisht çështje tjera, siç është liberalizimi i vizave dhe lobi të pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën.

**Donika Kadaj – Bujupi** tha se Kosova jashtë vendit duhet të përfaqësohet drejt, pavarësisht pozitë dhe opozitë, interesat e vendit duhet të jenë para interesave partiake. Mendon se është shumë me rëndësi dhe inkurajuese vazhdimi i mbështetjes së fuqishme të Gjermanisë në këto muajt e fundit, sidomos në proceset integruese, në përgjithësi po edhe në çështjen e vizave edhe në temën e kufijve. Beson se kështu duhet angazhim që të vazhdohet kjo mbështetje edhe më tutje. Po ashtu mendon se është një hap shumë pozitiv fillimi i raporteve me Greqinë dhe Sllovakinë, nuk e dinë a është e mundur dhe mjaftueshëm me u trajtuar, si dhe a ka hapësirë që të ketë diplomaci parlamentare sepse aty ku qeveritë për shkak të specifikave nuk mund të kenë kontakte të drejtpërdrejta ose janë të kufizuara, ka hapësirë për diplomaci parlamentare pavarësisht a njihemi a jo si shtete reciprokisht, deputetët mund të takohen dhe të bëjnë punën e tyre në fushat e tjera të cilat do të ndihmojnë në integrimin e rajonit.

Mendon se përmbyllja e kritereve nga ana e Kosovës për çështjen e liberalizimit është temë e mbyllur dhe e konfirmuar nga vetë Bashkimi Evropian dhe nuk e shohë të shëndetshme që nga brenda me i vu kritere të reja vetes. Sundimi i ligjit nuk ka tavan edhe sigurisht që ka probleme të shumta, por kjo nuk nënkupton se tani, si Kosovë duhet të nxjerrim kritere të reja. Thëkson se 1 kriter e kemi nxjerrë vetë në vitin 2011 edhe e dimë sa problemet na i ka shkaktuar, prandaj nuk është mirë me përsërit gabimin e njëjtë. Mendon se është vendim i cili i takon Bashkimit Evropian dhe në raportin e juaj është plotësisht e drejtë që të pritet që tani të reflektojë Evropa, sepse ne i kemi kryer detyrat tona. Gjithmonë duke qenë kritike në atë që ne duhet të angazhohemi të gjithë bashkë më shumë në temat të cilat lidhen edhe me zhvillimin ekonomik edhe me sundimin e ligjit edhe me investimet, por nuk është temë që mund të japë rezultatet e saja as për 6 muaj as për një vit, është proces. Thotë seçka dëshiron ta ngritësi shqetësim, janë konsullatat tona të cilat kisha dashtë meqë janë edhe ekipi i juaj këtu, me filluar me kërkuar pak më shumë përgjegjësi, për shkak se ka shumë bashkatdhetarë, të cilët po na drejtohen neve si deputet dhe ankohen që nuk marrin përgjigje në pyetjet e tyre, në e-mailat që iu dërgohen, me telefonatat për çështje krejt teknike, për shembull si mund ta nxjerrim pasaportën nëse jeton në Frankfurt mos të shkoj në Kosovë, si mund ta vazhdojë, domethënë janë çështje krejt teknike por diku diçka po ngec. Beson sedo të ishte mirë nëse marrim nga një kërkesë shtesë që të jenë më efikas në punët e tyre sepse ata drejtpërdrejt nuk ballafaqohen me diasporën, ndërkaq thekson se janë vetë të zgjedhurit e tyre të cilët vazhdimisht kontaktohen dhe iu kërkohet që ta trajtojnë këtë çështje, beson se zotëri Alberti e dinë më mirë sepse ka kohë në ministri edhe është njohës i këtyre rrethanave. Thotë se çka mundemi ne me bërë më shumë si Parlament, besoj që duhet të kemi një bashkëpunim më të afërt dhe takime më të shpeshta me ju, përkundër jo takime çdoherë zyrtare edhe para mediave sepse aty nuk kryhen punë por takime përmes grupeve punuese edhe bashkëpunim më të afërt e thashë aty ku ne mund të kontribuojmë edhe për shkak të përvojës edhe për

shkak të pozitive që kemi si deputetë dhe mund të fillon një bashkëpunim ndërparlamentar. Çdo herë na është thënë që është shumë e mirëseardhur, por të drejtën me të thënë në të kaluarën nuk ka pas vullnet me pas një veprim konkret që do të thotë deputetët të kenë mundësi të japin kontributin e tyre ma të madh. Shton se shpeshherë informohemi nga mediat për problemet të cilat besojmë që nëse me homologët tonë i trajtojmë në takimet e ndryshme do të merrnin formë tjetër dhe do të kishim rezultate më të mira. Faleminderit shumë!

**Behgjet Pacolli** tha se sa i përket veprimeve të cilat janë të lidhura drejtpërsëdrejti me “MSA”-në, janë veprime të cilat kanë një specifik nëse flitet për Ministrinë e Punëve të Jashtme për shembull, nëse flasim për sanksionet po e vërtetë këtë vit do të miratohet ligji, nuk varet krejt prej nesh edhe me ministri tjera, por kemi dëshmi se në Qershor të këtij viti ne do ta kemi këtë pjesën legjislative të masave, ne do ta përkryejmë, mos mendoni që s’kemi punuar, kemi punuar jashtëzakonisht shumë, por na kemi vepruar këtu, kemi vepruar gjithmonë do të thotë në harmoni me Bashkimin Evropian dhe një ligj do ta kemi këtë vit, nuk është varur krejt prej nesh kjo. Thekson se sa i përket masave zbatuese, planit të veprimit do të thotë zhvillimi sa më efikas i dialogut politik, sigurisht nuk është vetëm një çështje e Ministrisë së Punëve të Jashtme që sot ka pritur ajo punë, sot kemi vepruar dhe nesër e kryejmë atë dhe është krye, varet gjithmonë është sikurse një zinxhirë praktikisht i pafund që gjithmonë problemi e nxjerr problemin tjetër dhe kjo do të jetë edhe në të ardhmen. Ne asnjëherë nuk do të jemi në gjendje me thanë e kemi përkryer punën tonë, për arsye se është një proces i pafund, do të thotë një proces që gjithmonë vazhdon.

U shpreh se ka veprime që punohet shumë gjatë, janë konsultat politike, në rajon shkojnë delegacionet vijnë delegacionet takohemi dhe ne vijmë deri në një përfundim se duhet të nënshkruhet marrëveshje, ajo marrëveshje tash pret ose ardhjen e ministrit ose shkuarjen e tij atje dhe me gjetur diçka kur nënshkruhet ajo. Ardhjet e shkuarjet nuk janë ato që bëhen çdo ditë por janë vizita, nëse unë dëshiroj tash me vizituar një shtet diku Bullgarinë, ndoshta ma japin terminin në Tetor, tash nuk mundem me insistuar me shkuar përpara ose e kundërta, ne i përshpejtojmë vizitat, kush vjen te ne vjen shumë shpejt se gjendemi në moment dhe kohë reale në krahasim me problematikën, do të thotë gjejmë një harmonizim, për shembull nëse vizita e ardhjes së Ministrit të Punëve të Jashtme të Malit të Zi, për shembull ka pritur një vit derisa ka ardhur e kemi nënshkruar, kjo mund të konsiderohet si e kryer, mirëpo ka filluar ndoshta dialogu tjetër për një marrëveshje tjetër dhe këtë duheni ta kuptoni se mos pritni nga Ministria e Punëve të Jashtme që i ka krye punët gjithmonë, se çdo ditë ndryshon situata, çdo ditë sfida të reja, hapja e kapitujve të rinj, dialogut të ri dhe kjo do ta përcjellë gjithmonë Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Thekson se ato që varen nga ne për shembull vizat, e kemi një raportim të efektshëm gjithmonë, në kohë reale dhe e dimë tamam sa Viza janë lëshuar, ku janë lëshuar, kujt iu kanë lëshuar ato kështu që nuk është krejt faji i jonë që nuk i kemi përkryer detyrat e tona, por ne jemi në proces e sipër gjithmonë. Sa i përket punësimeve politike nuk besoj se ka pasur përfolje ose dikush do të kishte një arsye të fuqishme ta akuzojë Ministrinë e Punëve të Jashtme se e ka bërë këtë. Ministria e Punëve të Jashtme, po ka angazhuar njerëz politikë, por besoni se ne kemi shikuar që të punojmë sipas kriterit të kualitetit dhe ky ka qenë kriteri kryesor te ne, këtë e kemi bërë. Por nga ana tjetër duhet ta pranoni se në ministrinë e kemi gjetur diku sa ka qenë bilanci, diku 80 - 20, 75 - 25 ne kemi ardhur sot 50 - 50, bile jemi më tepër me njerëz të karrierës sesa politikë dhe tendenca është në avancim të këtij parimi. Thekson se Ai si AKR, pasi u fol për

punësime politike tha se nuk kam dërguar asnjë deri tash, asnjë njeri, planifikohet një njeri me lëshuar tash një konsull dhe të ju them drejtën unë skam dërguar asnjë të AKR-së, as s' kam tentuar...

Thekson se kemi ditë të bëjmë përzgjedhje të mirë deri tani sipas asaj që shihet dhe unë këtë barometër e shoh, jo vetëm te puna, te raportet që ne i marrim, do të ju shpjegoj edhe mënyrën e raportimit të konsujve dhe të ambasadave tona, por e shoh edhe si ekziston marrëdhënia me vendin nikoqir- shembull. Ne kemi kthesa në disa shtete me ambasadorë të rinj, kemi kthesa të mira. Por kemi edhe vende ku situata do të thotë është tjetër, e ne jemi duke intervenuar aty që të ndërrojmë situatën, ndërrojmë gjendjen dhe jemi duke e bërë këtë me shumë përgjegjësi, me shumë përgjegjësi ju them. U shpreh se sa i përket raporteve, e kanë parim që të kenë raport ditor për ambasadat tona për njerëzit përgjegjës dhe ata i dërgojnë, ditën e nesërme do të thotë duhet të jenë raportet këtu, unë besoj se drejtori është i kënaqur me raportet që vijnë dhe i kemi të gjitha bukur të klasifikuara, janë do të thotë aty mund të shihen edhe nga ju janë aksesibël, kështu që ka raportime. Konkluzat prej këtyre raporteve i nxjerrim për arsye se ne takohemi edhe pse staf politik me krejt stafin civil, do të thotë me Ministrinë me drejtorin kemi bashkëpunim të mirë dhe takohemi pothuajse çdo ditë dhe i diskutojmë problemet gjithmonë në favor të përmirësimit të kualitetit. E di për cilin person po flitni tani, që është kthye pa i bërë 3 vjet ende, është punëtor i mirë, por ky person ky njeri i nevojitet Ministrisë tani siç edhe ne kemi disa vende këtu të cilat duhet të mbulohen pre njerëzve adekuat, njerëzve me eksperiencë dhe këta njerëz sigurisht do të angazhohen në këto poste.

Thekson se Drejtori është një diplomat i shkëlqyer dhe drejtori e di që derën e ka gjithmonë hapur dhe drejtori e di që atë ditë kur e shpreh vullnetin ky me shkuar diku, sigurisht unë do të isha krenar ta dërgojë në një vend tjetër, mirëpo ky është aq i nevojshëm këtu tash në Ministri për arsye se ne jemi duke bërë punë të mira brenda edhe kështu ju ftoj kryetare që një ditë të vini, të vini edhe të na e bëni një vizitë, besoj se e meritojmë vizitën e juaj.

Thekson se vizita mundet me u bërë, jeni këtu, ejani lirisht do të ju informoj edhe më tepër aty, ndoshta për punët si punojmë dhe çfarë metodologjie përdorim, besoni se në atë Ministri është bë po më vjen keq me thanë se je këtu drejtor por unë besoj se ke bashkëpunim të mirë me zyrën politike, ke bashkëpunim të mirë edhe me ministrin edhe me zëvendësministrin, por besoj se edhe ne kemi kontribuar shumë çështjes dhe sot mund të jemi një ministri shembull në rajon, kur e them këtë kam të drejtë të ju them për arsye se aty nuk kemi pasur as salla të pranimit të njerëzve, nuk kemi pasur as salla protokollare sot e kemi kthye në një ministri të dinjitetshme dhe ajo më bën shumë të krenohem me Kosovën dhe normalisht edhe sa i përket efikasitetit, ne kemi rritje të efikasitetit të punës, nuk është një ministri që shëtisin njerëzit poshtë e përpjetë por është një Ministri që dihet kur fillon puna dhe ku kryhet puna, jo nëpër kafe, por në zyre dhe bashkëpunimi me stafin diplomatik është në nivel, mirëpo normalisht ka edhe shumë punë për t'u bërë. Thekson se kemi të angazhuar, por kanë reduktuar pak numrin. Sa i përket Gjermanisë u shpreh se kemi jashtëzakonisht bashkëpunim të mirë, jam shumë i lumtur që kemi arritur me krijuar një, si po e quajnë Gjermanët "Ajnklag", harmonizim edhe të ideve edhe të veprimeve dhe nuk do të ndalemi në këtë drejtim. Një qëllim të tillë e kemi ta bëjmë edhe me Francën edhe me Italinë. Theksoi se ishte në Itali para pak dite, e shfrytëzoi vikendin të shtunën edhe të dielën, u takua me njerëz të rëndësishëm, u takua me kolegun, ishte vizitë krejtësisht jashtë, jo protokollare me zëvendëskryeministrin dhe unë besoj se zëvendëskryeministri i Italisë edhe pse po ju them këtë jashtë do të vjen në vizitë te ne. Theksoi se me Francën po ashtu kemi bashkëpunim shumë të mirë dhe gjërat e bukura nuk ndodhin brenda natës.

Jam jashtëzakonisht i prirë të ju them se i ndaj mendimet me ju për atë që insiston, ta dini. Ne e kemi një akord të jashtëzakonisht të përpunuar mirë, të studiuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Jo vetëm tani kur e kemi një Ministër nga Kosova, por edhe me ministrin Bushati të cilin e falënderoj për bashkëpunim. Thekson se kemi filluar një iniciativë që ne të hapim konsullata të përbashkëta, të hapim përfaqësi të përbashkëta në vendet ku ne nuk mundemi të kemi ambasada për shkak të njohjes, të hapim ata dhe t'i shfrytëzojmë së bashku, kurse në vendet ku kemi ambasada dhe ku mundemi të hapim ambasada ne do të hapim dhe ata do të jenë të përfaqësuar aty, është në proces e sipër mos të ju shpjegoj është një kronologji e punëve që është bërë dhe do të njiheni në kohë reale sigurisht, e pres homologun tim që të vjen në Kosovë dhe të nënshkruajmë marrëveshjen para takimit të radhës të dy qeverive. Beson se do të jemi të përfaqësuar edhe në Kinë, përmes ambasadës së Shqipërisë dhe kërkoi që mos të del në media. Shtoi se janë disa vende strategjike ku ne do t'i dërgojmë ku do t'i dërgojmë përfaqësuesit tanë dhe do të punojnë për Kosovën dhe normalisht në përfaqësitë ku jemi ne do të vijmë ata. Kështu tendenca t'ij është që edhe në Uashington të kemi një ndërtesë të përbashkët në të ardhmen edhe pse jo në Berlin edhe në Romë.

**Blerta Deliu – Kodra** i falënderoi deputetët për prezencën dhe para përfundimit të mbledhjes e lexoi një lajm se njëra prej mediave prestigjioze në pjesën gjermano-frënge, Televizioni Art e ka portretizuar Kosovën në një dokumentar si shtet me flamuj dhe simbole Islamike. Theksoi se është mirë të paktën me këto misione tona që i kemi me qenë të përgjegjshme. Tha se sipas lajmit paska qenë një dokumentar i 12 minutave që besoj shumë që me pas pak vëmendjen përfaqësuesit tanë, zyrat tona, misionet tona që i kemi në këto vende që të reagojnë. TV Arta e paskan mediat këtu domethënë e kanë portretizuar Kosovën si shtet Islamik me flamuj, theksoi se rasti i fundit, sidomos tërheqja që e kemi bërë ka me çuar edhe sinjale pozitive në raport me qytetarët e Kosovës dhe vetë pozicionin tonë si shtet.

**Behgjet Pacolli** u shpreh se Serbia është duke punuar në të gjitha drejtimet, kështu që mos u habitni nëse ju them nuk kisha dashtë, por mos u habitni nëse ju them që edhe mediat tona mundën me qenë të influencuara absolutisht prej...

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

**E përgatiti**

**Stafi mbështetës i komisionit**

**Kryetare e Komisionit,  
Blerta Deliu-Kodra**

-----